



RAPORT GJYSMËVJETOR

PËR PUNË
DHE PUNËN FINANCIARE



НУЦК „ИЉО АНТЕСКИ-СМОК“-ТЕТОВО
INQK "ILO ANTESKI-SMOK"-TETOVË
NICC "ILO ANTESKI-SMOK"-TETOVO

2025
Tetovë

██████████

Në bazë të nenit 31-b, paragrafi (1) i Ligjit për Kulturë ("Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 44/2014) dhe nenit 12, pika 10 e Statutit të INQK "Ilo Anteski Smok"- Tetovë, nr. 0101-18/6 miratuar më datë 16.04.2015, Drejtori i Institucionit Nacional Qendra e Kulturës "Ilo Anteski-Smok"- Tetovë, paraqet:

|

**RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PUNË
DHE PUNËN FINANCIARE TË
INSTITUCIONIT NACIONAL QENDRA E KULTURËS
"ILO ANTESKI-SMOK"-TETOVË
PËR PERIUDHËN 01.01.2025-30.06.2025**

PËRMBAJTJA

01	Hyrja	4
02	Organet udhëheqëse dhe drejtuese	5
	I.1 Organ udhëheqës -Drejtori	5
	I.2 Organ drejtues -Këshilli drejtues	5
03	Pjesa programore	6
	II.1 Aktivitetet	6
	II.2 Raport natariv	8
04	Raporti financiar	16
05	Përfundimi	21

Hyrje

Qendra e kulturës „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë është ndërtuar në vitin 1973, ndërsa administrata zyrtarisht me punë filloi në vitin 1975. Objekti ka sipërfaqe prej 6500 m², nga e cila 780 m² janë pjesë e skenës.

Për organizim të aktiviteteve skenike, Qendra për kulturë posedon sallë të madhe me 661 ulëse, si dhe sallë të vogël me 50 ulëse për promovime të ndryshme.

Qendra për kulturë është institucion i rëndësishëm për kulturën, aktivitetet kulturore dhe skenike, të cilat realizohen në qytetin e Tetovës dhe rrethinën në përgjithësi. E gatshme për organizim të koncerteve, aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe skenike, shfaqje, promovime, ekspozita, koncerte të ansambleve, mbajtje të aktiviteteve politike dhe njëkohësisht me veprimet e veta në mënyrë aktive vepron në promovimin dhe realizimin e vlerave kulturore.

Për çdo vit në këtë objekt aktivitetet e tyre i zhvillojnë qindra aktorë të profileve të ndryshme nga të gjitha nacionalitetet dhe gjuhë të ndryshme, aktorë, muzikantë, këngëtarë, kore, fotograf. Në qendrën për kulturë në vit organizohen mbi 100 aktivitete me mbi 50.000 vizitorë.

I.ORGANET UDHËHEQËSE DHE DREJTUESE

I.1. ORGAN UDHËHEQËS DREJTORI

Institucioni Nacional Qendra e Kulturës “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, udhëhiqet nga drejtori. Drejtorin e zgjedh ministri i kulturës dhe turizmit me konkurs publik të shpallur nga Ministria e kulturës dhe turizmit dhe me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Drejtori i institucionit për periudhën nga 01.01.2025–30.06.2025 vit, ka udhëhequr, koordinuar dhe ka eliminuar të gjitha pengesat e mundshme, për realizim efikas të aktiviteteve amë, aktiviteteve që organizohen nga shoqata si dhe institucione të ndryshme.

I.2. ORGAN DREJTUES KËSHILLI DREJTUES

Këshillin drejtues të Qendrës për kulturë e përbëjnë 5 (pesë) anëtarë të cilët i emëron dhe shkarkon ministri i kulturës dhe turizmit, nga të cilët dy janë nga radha e përfaqësuesve nga sfera e kulturës, një është nga pushteti i vetë administrimit lokal dhe dy përfaqësues nga të punësuarit në Qendrën për kulturë. Këshilli Drejtues në periudhën nga 01.01.2025–30.06.2025 vit, ka realizuar gjithsej 5 (pesë) seanca, të dhëna në mënyrë tabelore.

Data e seacave	Vendime	Pëlqime	Miratime
27.02.2025	2	/	3
07.03.2025	/	1	1
28.03.2025	1	/	1
15.04.2025	1	/	/
23.06.2025	2	1	/
Gjithsej	6	2	5

II. PJESA PROGRAMORE

II.1. AKTIVITETET

INQK. "Ilo Anteski Smok" – Tetovë, në objektin e saj për prezantimin e ngjarjeve të ndryshme, ka një sallë të madhe me 661 ulëse dhe një sallë të vogël të përshtatshme për promovime të ndryshme të vogla me 50 ulëse.

Në periudhën 01.01.2025 deri më 30.06.2025, në Qendrën e Kulturës janë mbajtur gjithsej 45 manifestime të ndryshme, shumica e të cilave janë aktivitete drame dhe muzikore. Në këto aktivitete morën pjesë 22.980 artdashës nga të gjitha nacionalitetet dhe fetë në Qendrën e Kulturës.

Sallën e madhe të Qendrës së Kulturës e shfrytëzon proporcionalisht Teatri i Tetovës, çdo të enjte dhe të premte të vitit, si dhe datat e tjera para realizimit të premierave, dhe në total për këtë periudhë salla është shfrytëzuar për 22 ditë.

Aktivitetet e ndara sipas llojeve, për periudhën 01.01.2025 – 30.06.2025, do të duken si në një pasqyrë tabelare:

Nr.	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
1	Shfaqje	16
2	Muzikë klasike	2
3	Folklor	6
4	Ekspozita	1
5	Manifestime	2
6	Tribuna	4
7	Takime politike	1
8	Aktivitete për fëmijë	6
9	Aktivitete humanitare	2
10	Koncerte	3
11	Film	1
12	Trajnim	1
Gjithsej		45

Sipas kategorisë së moshës

Nr.	Kategoria e moshës	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1	deri në 12	12	7.500
2	+12	2	1.150
3	+18	31	14.330
Gjithsej		45	22.980

Aktivitetet në bazë nacionale

Nr.	Aktivitetet sipas nacionaliteteve	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1	Të përzier	10	4.280
2	Shqiptarë	24	12.050
3	Maqedonas	10	6.000
4	Turq	1	650
Gjithsej		45	22.980

Qendra e Kulturës ka lidhur kontrata me të gjithë organizatorët, përveç Teatrit të Tetovës, i cili ndodhet në të njëjtin objekt me institucionin tonë.

Kontrata të lidhura	Lirim nga pagesa	Vlera
Me leje nga Ministria e kulturës dhe Qeveria	0	0
Teatri i Tetovës	22 ditë	0

II.1. RAPORT NARATIV

Janar 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Tribunë	BFI	02.01.2025	650
Shfaqje	Muzeu Virtual	10.01.2025	100

01 ■ 02.01.2025 (e enjte)

Në organizatën e Bashkësisë Fetare Islame, e përfaqësuar nga Selver Xhemaili, në sallën e madhe u organizua një aktivitet fetar. 650 vizitorë marrin pjesë në aktivitet.

02 ■ 10.01.2025 (e premte)

Në organizim të Muzeut Virtual, në sallën e vogël të qendrës së kulturës u mbajt shfaqje filmi "Historiani dhe Kameleonët". Në këtë aktivitet ishin 100 vizitorë.

Shkurt 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Takime politike	Aleanca për shqiptarët	23.02.2025	650
Tribunë	BFI	27.02.2025	650

01 ■ 23.02.2025 (e diell)

Në organizimin e Aleancës për Shqiptarët - Tetovë, në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës është mbajtur tubim politik. Në këtë aktivitet ishin 650 vizitorë.

02 ■ 27.02.2025 (e enjte)

Në organizatën e Bashkësisë Fetare Islame, e përfaqësuar nga Selver Xhemaili, në sallën e madhe u organizua një aktivitet fetar. 650 vizitorë marrin pjesë në aktivitet.

Mars 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Alen Haxhiç	02.03.2025	650
Koncert	Komuna e Tetovës	03.03.2025	650
Tribunë	Shoqata "Uniteti Islam"	09.03.2025	650
Koncert humanitar	Kryqi i kuq	14.03.2025	350
Koncert humanitar	ASR	27.03.2025	650

- 01 ■ **02.03.2025 (e diel)**
Në sallën e madhe u organizua Stand up show nga Alen Haxhiç. 650 vizitorë marrin pjesë në aktivitet.
- 02 ■ **03.03.2025 (e hënë)**
Në organizim të Komunës së Tetovës, në sallën e madhe , u mbajt koncert për ditën e Komunës. Në këtë aktivitet ishin 650 vizitorë.
- 03 ■ **09.03.2025 (e diel)**
Në organizimin e Unitetit Islam , me rastin e muajit të Ramazanit në sallën e madhe u mbajt tribunë fetare. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 vizitorë.
- 04 ■ **14.03.2025 (e premte)**
Në organizatën e Kryqit të Kuq është realizuar një koncert humanitare. Në këtë aktivitet ishin 350 vizitorë.
- 05 ■ **27.03.2025 (e enjte)**
Në organizim të shoqatës ASR është organizuar tribunë me rastin e muajit të Ramazanit. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 vizitorë.

Prill 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Teatri i Tetovës	05.04.2025	300
Shfaqje	Teatri i Tetovës	11.04.2025	250
Folklor	SHKA "Xheladin Zeqiri"	18.04.2025	650
Aktivitet për fëmijë	SH.F "Istigball"	22.04.2025	600

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Shoqata "Leteçka teatarska trupa"	23.04.2025	1.000
Tribunë	Medreseja "Isa beu"	25.04.2025	650
Shfaqje	Teatri i Tetovës	28.04.2025	300
Aktivitet për fëmijë	SH.F "Shemshova"	30.04.2025	500

- 01 ■ **05.04.2025 (e shtunë)**
Në organizim të Teatrit të Tetovës, në sallën e madhe , u mbajt repriza e shfaqjes "Pacienti i Dr.Frojdit". Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.
- 02 ■ **11.04.2025 (e premte)**
Në organizim të Teatrit të Tetovës u organizua repriza e shfaqjes "Dredhitë e Patukut". Në këtë aktivitet ishin 250 vizitorë.
- 03 ■ **18.04.2025 (e premte)**
Në organizim të SHKA "Xheladin Zeqiri", u mbajt koncert me talentët të rinj. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 04 ■ **22.04.2025 (e mërkutë)**
Në organizim të shkollës fillore "Istigball" Tetovë, u mbajt manifestimi për fëmijë, me rastin e ditës ndërkombëtare e fëmijëve. Në këtë aktivitet ishin 600 vizitorë.
- 05 ■ **23.04.2025 (mërkurë)**
Në sallën e madhe u mbajt shfaqja teatrale për fëmijë "Fëmija e ujkut" nga Studioja e dramës "Leteçka teatarska trupa" - Tetovë. Në këtë aktivitet ishin 1.000 të pranishëm.
- 06 ■ **25.04.2025 (e premte)**
Në sallën e madhe me organizim të Medresesë "Isa Beu" u mbajt një aktivitet fetar. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 650 vizitorë.
- 07 ■ **28.04.2025 (e hënë)**
Në organizim të Teatrit të Tetovës u organizua repriza e shfaqjes "Armiku i Popullit". Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.
- 08 ■ **30.04.2025 (e mërkurë)**
Në organizim të shkollës fillore "Shemshova", u mbajt aktiviteti për fëmijë "Ndrysho". Në këtë aktivitet ishin 500 vizitorë.

Maj 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Folklor	SHKA "Kiril Pejçinoviç"	03.05.2025	600
Shfaqje për fëmijë	Shoqata "Leteçka teatarska trupa"	05.05.2025	650
Film	Netting School	06.06.2025	650
Shfaqje	Teatri i Tetovës	09.05.2025	300
Manifestim	BFI	10.05.2025	650
Koncert klasik	Shoqata "Artal"	15.05.2025	500
Shfaqje	Shoqata kroato-maqedonase	16.05.2025	650
Shfaqje	Gëzim Qahili	17.05.2025	400
Folklor	INQK "Ilo Anteski-Smok" Tetovë	19.05.2025	650
Shfaqje	SHKA "Ilo Anteski-Smok"	21.05.2025	350
Koncert	Anita Aziri	23.05.2025	600
Aktivitet për fëmijë	Çerdheja "Mlladost"	27.05.2025	650
Manifestim	Medreseja "Isa beu"	28.05.2025	650
Ekspozitë	INQK "Ilo Anteski-Smok" Tetovë	29.05.2025	50
Koncert klasik	Shoqata "Artal"	30.05.2025	100

01 ■ 03.05.2025 (e shtunë)

Në organizim të shoqatës kulturore artistike "Kiril Pejçinoviç" Tearcë, u mbajt manifestim për ditët e Kiril Pejçinoviçit. Në këtë aktivitet ishin 600 vizitorë.

02 ■ 05.05.2025 (e hënë)

Në sallën e madhe u mbajt shfaqja teatrale për fëmijë "Borëbardha dhe shtatë xhuxhat" nga Shoqata "Leteçka teatarska trupa" - Tetovë. Në këtë aktivitet ishin 1.000 të pranishëm.

03 ■ 06.05.2025 (e martë)

Në organizim të shoqatës Netting school u shfaq filmi "Pasaporta", në regji të Eduart Grishaj. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

04 ■ 09.05.2025 (e premte)

Në organizim të Teatrit të Tetovës u organizua repriza e shfaqjes "Revolta e presjes". Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.

05 ■ 10.05.2025 (e shtunë)

Organizuar nga Muftinija e Tetovës, në sallën e madhe u mbajt manifestimi për haxh. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

06 ■ 15.05.2025 (e enjte)

Organizuar nga shoqata "Artal" në hapësirat e sallës së madhe në INQK. "Ilo Anteski-Smok" hapi Festivalin "Meridians", me korin e fëmijëve "Crescendo". Në këtë aktivitet ishin 500 vizitorë.

07 ■ 16.05.2025 (e premte)

Organizuar nga "Shoqëria Maqedono-Kroate" në hapësirat e sallës së madhe në INQK. "Ilo Anteski-Smok" – Tetovë u mbajt një shfaqje me pjesëmarrës nga Kroacia. Në këtë aktivitet ishin 650 vizitorë.

08 ■ 17.05.2025 (e shtunë)

Organizuar nga Gëzim Qahili në sallën e madhe në ambientet e Qendrës së Kulturës u organizua – Stand up comedy. Kishte gjithsej 400 vizitorë.

09 ■ 19.05.2025 (e hënë)

Organizuar nga INQK. "Ilo Anteski-Smok" – Tetovë, në bashkëpunim me SHKA "Jeni Hajat" – Tetovë, në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u organizua koncert folklorik me rastin e 19 majit, ditës së rinisë, sportit dhe përkujtimit të Ataturkut. Ky projekt u mbështet nga Ministria e Kulturës. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 vizitorë.

10 ■ 21.05.2025 (e mërkurë)

Organizuar nga SHKA "Ilo Anteski Smok" në hapësirat e sallës së madhe u mbajt shfaqja teatrale për fëmijë "Dy zanat e vogla". Në këtë aktivitet ishin 350 vizitorë.

11 ■ 23.05.2025 (e premte)

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, në sallën e madhe të Qendrës së kulturës u mbajt koncerti solistik i Anita Azirit dhe Bendit "Artemis". Në këtë aktivitet ishin 600 vizitorë.

12 ■ 27.05.2025 (e martë)

Në organizim të Çerdhes "Mlladost" në sallën e madhe në ambientet e INQK "Ilo Anteski-Smok" u realizua aktivitet për fëmijë. Në shfaqje ishin 650 vizitorë.

13 ■ 28.05.2025 (e mërkurë)

Në sallën e madhe me organizim të Medresesë "Isa Beu" u mbajt manifestimi i përcjelljes së gjeneratave. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 650 vizitorë.

14 ■ 29.05.2025 (e enjte)

Organizuar nga INQK "I.A.-Smok", dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, në holl u organizua ekspozita e pavarur e Esra Lutës, "Flow in the flower". Në këtë aktivitet morën pjesë 50 vizitorë.

15 ■ 30.05.2025 (e premte)

Në vazhdimësi të festivalit ndërkombëtar "Meridians", shoqata "Artal" realizoi koncertin e radhës "Trio koncert". Në këtë aktivitet ishin 100 vizitorë.

Qershor 2025

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Aktivitet për fëmijë	Jabollçinja	01.03.06.2025	1000
Shfaqje për fëmijë	Shoqata "Letečka teatarska trupa"	02.06.2025	650
Shfaqje për fëmijë	SHKA "Ilo Anteski-Smok"	04.06.2025	300
Aktivitet për fëmijë	Studioja e baletit "Menada"	08.06.2025	500
Folklor	SHKA "Izvor"	09.06.2025	500
Shfaqje	Teatri i Tetovës	10.06.2025	300
Shfaqje	Teatri i Tetovës	11-13.06.2025	200
Aktivitet për fëmijë	Studioja e baletit "TUTU"	14-15.06.2025	1000
Trajnim	Shoqatë për filozofi të zbatuar	17.06.2025	30
Folklor	SHKA "Jehona e Malësisë "	18.06.2025	600
Folklor	INQK "Ilo Anteski-Smok"-Tetovë	19.06.2025	250
Shfaqje për fëmijë	Vision Academy	20.06.2025	300
Koncert	Festivali ndërkombëtar koral "TEHO"	28-29.06.2025	650

- 01 ■ 01.03.06.2025 (e diel, e martë)**
Në sallën e madhe u mbajt edicioni i 30-të i festivalit "Jabollçinja". 15 fëmijë shprehën talentin e tyre në të kënduar. Ngjarja kishin gjithsej 1.000 vizitorë.
- 02 ■ 02.06.2025 (e hënë)**
Në sallën e madhe u mbajt shfaqja teatrale për fëmijë "Princi i vogël" në organizim të studios së dramës "Letečka teatarska trupa" - Tetovë. Në këtë aktivitet ishin 650 të pranishëm.
- 03 ■ 04.06.2025 (e mërkurë)**
Organizuar nga SHKA "Ilo Anteski-Smok" në hapësirat e sallës së madhe u mbajt shfaqja teatrale për fëmijë e titulluar "Dy zanat e vogla". Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.
- 04 ■ 08.06.2025 (e diel)**
Në organizim të studios së baletit "Menada" nën koreografinë e Jelena Mirçevskës, në sallën e madhe u mbajt shfaqja e baletit "Stolen crown". Në këtë aktivitet ishin 500 vizitorë.
- 05 ■ 09.06.2025 (e hënë)**
Organizuar nga SHKA "Izvor" Jegunovcë, në hapësirat e sallës së madhe u mbajt koncerti jubilar për 20 vjetorin e themelimit të shoqatës. Në këtë aktivitet ishin 500 vizitorë.
- 06 ■ 10.06.2025 (e martë)**
Në organizim të Teatrit të Tetovës u organizua premiera e shfaqjes "Anatomia e revolucionit". Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.
- 07 ■ 11-13.06.2025 (e mërkurë, e premte)**
Në organizim të Teatrit të Tetovës u organizua rishfaqja e shfaqjes kamertale "Anatomia e revolucionit" në regji të Butrint Pashës. Në këtë aktivitete ishin gjithsej 200 vizitorë.
- 08 ■ 14-15.06.2025 (e shtunë, e diel)**
Organizuar nga Studio e Baletit "Tu-tu" në sallën e madhe në ambientet e INQK "Ilo Anteski -Smok" - këtë vit u realizua një shfaqje baleti "Inside out" me mësuesen Bora Qazimi. Ngjarja kishte gjithsej 1.000 vizitorë.
- 09 ■ 17.06.2025 (e martë)**
Në organizim të shoqatës për filozofi të zbatuar, në sallën "William Shakespeare" u mbajt një trajnim motivues me temë "Si të jemi të motivuar, si të kemi më shumë siguri dhe vetëbesim". Në ngjarje ishin 30 të pranishëm.

10 ■ 18.06.2025 (e mërkurë)

Organizuar nga SHKA "Jehona e Malësisë" në hapësirat e sallës së madhe u mbajt koncerti vjetor tradicional. Në këtë aktivitet ishin 600 vizitorë.

11 ■ 19.06.2025 (e enjte)

Organizuar nga INQK. "Ilo Anteski-Smok" - Tetovë, në bashkëpunim me Ansambli "Tanec", në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u organizua koncert folklorik "Ritmi i shpirtit, ngjyra e traditës". Ky projekt u mbështet nga Ministria e Kulturës. Në këtë aktivitet morën pjesë 250 vizitorë.

12 ■ 20.06.2025 (e premte)

Në organizim të Vision academy, në sallën e madhe u mbajt shfaqja përfundimtare për fëmijët e kurseve. Në këtë aktivitet ishin 300 vizitorë.

13 ■ 28-29.06.2025 (e shtunë, e diel)

Organizuar nga Festivali ndërkombëtar i koreve "Teho", në sallën e madhe në ambientet e INQK "Ilo Anteski -Smok" u mbajt koncerti i koreve. Në këtë aktivitet ishin 650 vizitorë.

III.1. RAPORTI FINANCIAR



TË DALAT, ZËRI 401 - RROGA BAZË

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Qendra e Kulturës ka bërë disa shpenzime të rëndësishme për pagat e punonjësve të saj. Këto shpenzime janë të lidhura ngushtë me sigurimin e një shërbimi cilësor dhe të qëndrueshëm për të gjitha aktivitetet kulturore dhe artistike që zhvillohen në këtë institucion. Shpenzimet për pagat e drejtuesve artistikë, punonjësve administrativ, punonjësve teknik, si dhe tatimi personal janë në vlerë gjithsej 7,352,231.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 402 – KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË

Kontributet e sigurimit shoqërorë ku bëjnë pjesë: kontributet bazë të SPI, kontributet bazë të shëndetësisë, kontributet personale shtesë, kontributet bazë të entit për punësim, janë një komponent i rëndësishëm i buxhetit operacional të institucionit. Këto kontribute janë thelbësore për sigurimin e mbrojtjes sociale dhe ekonomike për stafin, dhe përfaqësojnë një investim të rëndësishëm në mirëqenien e punonjësve. Vlera gjithsej e kësaj kategorie të shpenzimeve është 2,859,220.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 421 – SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI

Shpenzimet e Qendrës së Kulturës për energjinë elektrike, gjegjësisht ndriçimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme, funksionimi i pajisjeve elektrike dhe sistemi i ventilimit dhe kondicionimit të ajrit për 6500 m² të hapsirës shfrytëzuese, dhe atë infrastrukturën e njëjtë e shfrytëzojnë edhe institucionet e tjera si: Institucioni Nacional Teatri i Tetovës, Këndi Amerikan (American Corner Tetovo), Aleanca për gjuhen dhe kulturën franceze janë në vlerë gjithsej 1,233,732.00 denarë. Këto shpenzime kan qenë të vazhdueshme dhe kanë ndihmuar në sigurimin e një ambienti komod dhe funksional për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këtë institucion.

Shpenzimet për energjinë elektrike, taksat dhe shërbimet tjera komunale kan qenë të domosdoshme për të siguruar funksionimin e përditshëm dhe për të mbajtur mjedisin të pastër dhe të sigurt për të gjithë vizitorët dhe stafin. Në përgjithësi, shpenzimet për energjinë elektrike, taksat dhe shërbimet tjera komunale gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 kan qenë në vlerë të konsiderueshme gjithsej 1,366,224.00 denarë, por të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin efektiv të institucionit. Këto shpenzime kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi të sigurt, të pastër dhe të këndshëm për të gjithë përdoruesit e saj.

TË DALAT, ZËRI 464 – TRANSFERE TË NDRYSHME

Në këtë kategori të shpenzimeve, për Programin Vjetor për vitin 2025 të financuar nga Ministria e Kulturës, janë realizuar gjithsej 100,000.00 denarë, ndërsa për Programin Vjetor për vitin 2024 janë realizuar gjithsej 65,000.00 denarë, (pjesë e projekteve të përealizuara nga viti 2024), gjithsej 165,000.00 denarë, dhe përfshin:

Artet vizuele

- ☒ Ekspozita personale e Esra Luta "Flow in the flower" – pjesa e parë e realizuar 60,000.00 denarë, ndërsa pjesa e dytë e përealizuar 10,000.00 denarë.
- ☒ Ekspozitë kolektive "Pa titull" – (projekt nga viti 2024) pjesa e dytë e realizuar 5,000.00 denarë.
- ☒ Ekspozita personale e Gabriela Petrovska "Udhëtim në kohë" – pjesa e parë e realizuar 40,000.00 denarë, ndërsa pjesa e dytë e përealizuar 30,000.00 denarë.

Veprimtaria folklorike

- ☒ Koncerti vjetor SHKASH "Xheladin Zeqiri" – (projekt nga viti 2024) pjesa e dytë e realizuar 30,000.00 denarë.

Veprimtaria e letërsisë dhe botimeve

- ☒ "Nata poetike tetovare" – (projekt nga viti 2024) pjesa e dytë e realizuar 30,000.00 denarë.

Në përputhje me Programi Vjetor të I.N.Q.K. "Ilo Anteski Smok" – Tetovë, gjithashtu është realizuar një projekt i financuar nga mjetet vetanake në vlerë të përgjithshme prej 30,000.00 denarë, si më poshtë:

- ☒ Ansambli për valle dhe këngë popullore maqedonase "Tanec" – 30,000.00 denarë.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, përkatësisht në periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, institucioni ynë Qendra për Kulturë ka realizuar disa lloje shpenzimesh me qëllim sigurimin e funksionimit të pandërprerë të institucionit, mirëmbajtjen e higjienës, punën administrative si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe qëndrimit të vizitorëve, në vlerë gjithsej 599,947.00 denarë.

Brenda kësaj periudhe janë realizuar këto kategori shpenzimesh:

- **Shpenzime për shërbime postare dhe telekomunikacion**

Këto shpenzime përfshijnë pagesat për telefon dhe internet, si dhe shërbime postare të lidhura me komunikimin zyrtar dhe dërgimin/pranimin e dokumenteve dhe njoftimeve.

- **Produkte për mirëmbajtjen e higjienës**

Janë siguruar produkte higjienike si detergjentë, dezinfektues, sapunë, letra higjienike dhe të ngjashme, me qëllim mirëmbajtjen e rregullt të pastërtisë në ambientet e institucionit dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm.

- **Materiale dhe pajisje zyre**

Janë furnizuar materiale të domosdoshme për punën administrative, duke përfshirë tonerë për printera, letër zyre, stilolapsa, dosje, regjistra dhe material tjetër shpenzues për punën e përditshme të punonjësve.

Është realizuar blerja e një fotoaparati profesional me qëllim të përmbushjes së nevojave institucionale dhe përmirësimin e dokumentimit të aktiviteteve kulturore. Pajisja do të shërbejë për fotografimin dhe arkivimin cilësor të ngjarjeve artistike, ekspozitave, koncerteve, punësitorive dhe çdo aktiviteti tjetër që organizohet apo mbështetet nga institucioni ynë. Blerja është bërë me qëllim rritjen e efikasitetit në promovimin e aktiviteteve kulturore përmes materialeve vizuale me cilësi të lartë, si dhe për krijimin e një arkive të qëndrueshme që pasqyron veprimtarinë tonë.

• Inventar i imët

Janë blerë mjete dhe artikuj të ndryshëm nga inventari i imët që shërbejnë për përmirësimin e efikasitetit të punës dhe organizimin në ambientet e zyrës.

Vlera e përgjithshme e kësaj kategorie të shpenzimeve për realizimin e programit vjetorë, shpenzime për shërbime postare dhe telekomunikacion, produkte për mirëmbajtjen e higjienës, materiale zyre, inventar i imët dhe tranfere të ndryshme është gjithsej 764,947.00 denarë.

Bashkangjitje: Paraqitja tabelare e Raportit financiar të I.N.Q.K "Ilo Anteski-Smok"

I. TË HYRAT

Zëri	Përshkrimi i zërit	Vlera (denarë) zëri 603	Vlera (denarë) zëri 631	Vlera (denarë) zëri 787	Vlera (denarë) zëri 785	Gjithsej
723911	Qeraja nga objektet	0,00	235.310,00	389.140,00	0,00	624.450,00
741112	Transfere nga buxheti R.M.V.	11.742.675,00	0,00	0,00	0,00	11.742.675,00
741114	Teprica e të ardhurave të bartura nga viti i kaluar	0,00	99.028,00	157.213,00	0,00	256.241,00
Gjithsej		11.742.675,00	334.338,00	546.353,00	0,00	12.623.366,00

II. TË DALAT

Zëri	Përshkrimi i zërit	Vlera (denarë) zëri 603	Vlera (denarë) zëri 631	Vlera (denarë) zëri 787	Vlera (denarë) zëri 785	Gjithsej
401	RROGA BAZË	7.352.231,00	0,00	0,00	0,00	7.352.231,00
401130	Rroga bazë	6.756.539,00	0,00	0,00	0,00	6.756.539,00
401310	Tatimi personal i të ardhurave të rrogës	595.692,00	0,00	0,00	0,00	595.692,00
402	KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË	2.859.220,00	0,00	0,00	0,00	2.859.220,00
402110	Kontributet bazë të SPI	1.919.749,00	0,00	0,00	0,00	1.919.749,00
402210	Kontributet bazë të shëndetësisë	765.868,00	0,00	0,00	0,00	765.868,00
402220	Kontributet personale shitesë	51.060,00	0,00	0,00	0,00	51.060,00
402310	Kontributet bazë të entit për punësim	122.543,00	0,00	0,00	0,00	122.543,00
421	SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	1.366.224,00	0,00	0,00	0,00	1.366.224,00
421110	Energjia elektrike	1.233.732,00	0,00	0,00	0,00	1.233.732,00
421190	Taksa dhe shërbime tjera komunale	132.492,00	0,00	0,00	0,00	132.492,00
464	TRANSFERE TË NDRYSHME	165.000,00	292.089,00	307.858,00	0,00	764.947,00
464990	Transfere tjera	165.000,00	292.089,00	307.858,00	0,00	764.947,00
Gjithsej		11.742.675,00	292.089,00	307.858,00	0,00	12.342.622,00

I.GJITHSEJ TË HYRA 12.623.366,00

II.GJITHSEJ TË DALA 12.342.622,00

FITIMI NETO I REAZUAR MBI TË HYRAT 280.744,00

Përfundimi

Si përmbledhje e gjithçkaje të lartëpërmendur, mund të theksohen pikat e mëposhtme:

- Periudha 01.01.2025 deri 30.06.2025 ka përfunduar me një bilanc pozitiv të suksesit për Qendrën e Kulturës;
- Planifikimet financiare të shpenzimeve tre mujore te Qendrës për Kulturë nuk janë respektuar plotësisht nga Ministria e kulturës dhe turizmit;
- Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje për menaxhimin e përbashkët me Teatrin e Tetovës të shpenzimeve dhe të ardhurave për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e gjithë infrastrukturës sonë.



PUNUAR NGA:

M-r Sheval Sulejmani, Këshilltar për punë të përgjithshme administrative dhe punë juridike

Hakan Mejdii, Baashkëpunëtor profesional për marrëdhënie ndërkombëtare

Luljeta Shaqiri, Këshilltar për punë materiale financiare

Filiz Sulejmani, Këshilltar për IT

MIRATUAR NGA:

Artan Arslani, Udhëheqës programor

Dashnor Agolli, Udhëheqës i Sektorit për punë materiale-financiare dhe kontabilitet

Drejtor,

Njomza Imeri Ismaili